



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1022/4 Prot.

Tiranë, më 01/10/2018

V E N D I M

Nr. 187 , Datë 01 / 10 /2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 106, datë 17.07.2018, të paraqitur nga L.A kundër Kryeinspektorit, Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale Gjirokastër (ISHMPUT Gjirokastër) dhe Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë (ISHMPUT), me pretendimin për diskriminim për shkak të “bindjes politike¹”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash deklaroi se, në datë 21.02.2014 është emëruar në detyrën si Inspektor i Policisë Pyjore dhe ka zbatuar me përgjegjësi detyrat dhe për këtë arsye është ngritur në detyrën e Përgjegjës të Policisë Pyjore Tepelenë. L.A informon se në datë 20.04.2018 në aksionin e organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) “Pastrojmë Tokën që duam” në vendin e quajtur Ura e Viroit ka qenë i pranishëm pa braktisur për asnjë moment aksionin, kjo e vërtetuar me dokumentin e dërguar nga vetë kryeinspektori. Ndërkohë për braktisjen e aksionit ka marrë masë disiplinore “Vërejtje” për cilën është vënë në dijeni në datë 14.05.2018 dhe me datë 15.05.2018 e ka kundërshtuar këtë masë disiplinore por që nuk ka marrë asnjë përgjigje për dokumentacionin e kërkuar nga ana e ISHMPUT Gjirokastër. Në datë 12.07.2018 është njoftuar për shkresën nr.3547, datë 10.07.2018 me lëndë: “Njoftim për zgjidhje të marrëdhënies së punës”. L.A deklaroi se të gjitha veprimet dhe masat disiplinore në dëm të tij janë ndërmarrë për shkak se ai është anëtar i subjektit politik, Lëvizja Socialiste për Integrim, pra për shkak të bindjeve të tij politike.

¹ Subjekti ankues provon anëtarësinë e tij në subjektin politik, “Lëvizja Socialiste për Integrim”, nëpërmjet formularit të anëtarësisë datë 20.08.2016.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e punëdhënësit, dhe rregullimin e pasojave.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit Nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga subjekti ankues LA, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtua shqyrtimit të plotë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

- A. Me shkresën Nr. 1022/1, datë 20.07.2018 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, ISHMPUT Gjirokastër dhe ISHMPUT, në lidhje me ankesën për diskriminim të paraqitur nga ankuesi LA.

Me shkresën Nr. 3805/1, datë 13.09.2018 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ISHMPUT, informon se: *“LA është liruar nga detyra e Përgjegjësit të Sektorit të Policisë Pyjore Tepelenë, ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastër, me motivacionin: Mos pasqyrim i të dhënave lidhur me masa sigurimi, hetimi, dëbime apo vendime penale të formës së prerë brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë bazuar në nenin 13, të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe shkronjën “ç”, pika 3, Kreu III, të Vendimit nr.17/2016*

të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”. Gjithashtu, ju sjellim në vëmendje se kryeinspektori S.R, nuk është më i ngarkuar në detyrën e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Turizmit është institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe funksionon në bazë të Vendimit nr. 103, datë 04.02.2015, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve” (i ndryshuar) dhe Rregullores së Brendshme nr. 1, datë 15.09.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave në nivel qendror dhe nivel vendor”.

Me Urdhërin nr. 596, datë 21.02.2014, LA është emëruar në detyrën e Inspektorit në Sektorin e Policisë Pyjore në ISHMPU Gjirokastrë dhe me Urdhërin nr.271, datë 03.11.2016 është ngritur në detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Policisë Pyjore Tepelenë pranë ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë.

Në datën 11.05.2018, Kryeinspektori i ISHMPUT-së, mbështetur në shkresën nr. 165, datë 20.04.2018³, të dërguar nga Kryeinspektori i ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë, nëpërmjet Urdhërit nr. 207, datë 11.05.2018, i jep LA, masën disiplinore “Vërejtje”, me motivacion “*Moskryerja e detyrave duke braktisur aksionin “Pastrojmë tokën që duam”*”. L.A, nëpërmjet shkresës Memo, i është drejtuar z. A.L, Kryeinspektor, ISHMPUT-së dhe S.R, Kryeinspektor i ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë, në të cilën ka shprehur kundërshtimet dhe sqarimet e tij, në lidhje me masën e marrë. Pavarësisht memos së dërguar nga ankuesi, asnjë prej Kryeinspektorëve të sipërpërmendur, nuk i ka kthyer përgjigje ankuesit.

Me shkresën nr. 3547, datë 10.07.2018, të Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, ankuesi njoftohet për zgjidhje të marrëdhënieve të punës. Referuar shkresës në fjalë, zgjidhja e marrëdhënieve të punës ka ardhur si pasojë e moskryerjes së detyrave sipas procedurave ligjore. Shkresa nr. 3547, datë 10.07.2018, e Kryeinspektorit A.L është mbështetur në shkresën nr. 379, datë 03.07.2018, me lëndë “Propozim për largim nga detyra”, të Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë. Ndër të tjera, ankuesi njoftohet se duhet të paraqitet në një seancë bisedimesh, në të cilën do të parashtrihen arsyet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës si dhe për të shprehur kundërshtimet e tij mbi këtë proces. Seanca dëgjimore u realizua në datën 13.07.2018, në ISHMPUT, Tiranë.

³ Shkresa nr. 165, datë 20.04.2018, e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë, në vetëvete nuk përbën propozim për dhënie mase disiplinore, por nëpërmjet kësaj shkrese i jepet drejtpërdrejtë masë disiplinore, LA dhe 9 (nëntë) inspektorëve të tjerë, të cilët kanë braktisur aksionin “Pastrojmë tokën që duam”.

Për sa më sipër, gjatë analizimit të dispozitave përkatëse të Vendimit nr. 103, datë 04.02.2015, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve” (i ndryshuar) dhe Rregullores së Brendshme nr. 1, datë 15.09.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave në nivel qendror dhe nivel vendor” rezulton se nuk ka asnjë parashikim specifik dhe të qartë, lidhur me çështjen e dhënies së masave disiplinore për punonjësit e ISHPMUT-së, në nivel qendror apo edhe në degët rajonale. Por, referuar shkresës nr.3350, datë 04.07.2018 të ISHMPUT Tiranë, tërheqje vëmendje për S.R⁴, vlerësohet se dhënia e masave disiplinore është tagër i Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, pas marrjes së propozimit për masë disiplinore nga ana e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së në nivel rajonal.

Për sa më sipër, Komisioneri nuk ka kompetencë të shqyrtojë vlefshmërinë e masave disiplinore të dhëna nga Kryeinspektori i ISHPMUT-së, por fakti që nuk është reaguuar ndaj observacioneve të parashtruara nga ankuesi mbi 2 (dy) masat e para disiplinore të dhëna ndaj tij, është fakt që dëshmon për ekspozimin e L.A, ndaj një qëndrimi të padrejtë e disfavorizues, nga ana e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë, në kundërshtim me nenin 37, paragrafi 2, i ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), ku parashikohet shprehimisht: *“Procedura e shqyrtimit të masës disiplinore nga punëdhënësi duhet të garantojë të drejtën e punëmarrësit për t’u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova brenda një afati të arsyeshëm”*. Asnjë nga të drejtat e punëmarrësit nuk janë zbatuar në rastin e LA, për dy masat disiplinore të dhëna ndaj tij.

Njëkohësisht, fakt që provon për një qëndrim të padrejtë ndaj LA është edhe dhënia e masave disiplinore ndaj tij, nga ana e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë, pa patur asnjë kompetencë për të dhënë masa disiplinore ndaj inspektorëve në varësi të tij. Në bazë të interpretimit të pikave 6/a dhe 11 të Vendimit nr. 103, datë 04.02.2015, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve” (i ndryshuar), kompetenca për dhënie masash disiplinore i njihet vetëm Kryeinspektorit të ISHMPUT-së. Ndërkohë që nëse i referohemi shkresës nr. 165, datë 20.04.2018, të S.R, Kryeinspektor i ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë, rezulton se LA i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”.

Veprimet tendencioze të Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë në drejtim të ankuesit LA përforcohen më tepër dhe nga qëndrimet e mbajtura nga ana e tij në lidhje me masat disiplinore të dhëna në drejtim të S.R me shkresën nr.2192/1, datë 25.05.2018, tërheqje vëmendje, pasi ky i fundit ka propozuar largim nga puna për dy punonjës pa prova dhe fakte. Po ashtu dhe me shkresën nr.3350, datë 04.07.2018 të ISHMPUT Tiranë, S.R i është tërhequr përsëri vëmendja nga Kryeinspektori A.L duke i rikujtuar se nuk ka vendimmarrje për masë disiplinore, dhe së fundi me shkresën, Urdhër nr.335, datë 13.08.2018 të Kryeinspektorit A.L është bërë largimi i S.R nga detyra e Kryeinspektorit të ISHMPUT Gjirokastrë dhe vazhdimi i punës në detyrën e Inspektorit në Sektorin e Policisë Pyjore Përmet.

⁴ Në të cilën shkruhet se: “Bazuar në ankesat e njëpasnjëshme, të bëra nga punonjësit e ISHMPUT, dega Gjirokastrë, ju tërhiqet vëmendja për mosrealizimin e detyrave sipas procedurave ligjore. Jeni i ngarkuar në detyrën e Kryeinspektorit të ISHMPUT Gjirokastrë dhe si rrjedhojë, **nuk keni vendimmarrje për masë disiplinore**”

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nga ana e Kryeinspektorit të ISHMPUT-s janë marrë masat e nevojshme për rregullimin e situatës dhe vendosjen para përgjegjësisë të S.R duke e larguar nga drejtimi i ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë.

Në përfundim, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁵, Komisioneri gjykon se LA i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë.

B. Shkak i mbrojtur.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e Kryeinspektorit të ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁶ dhe trajtimit të pafavorshëm të ankuesit.

Pretendimi i LA se shkak për diskriminim ndaj tij janë bërë bindjet e tij politike, përbën një shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit 10221/2010. Nga shqyrtimi i dokumenteve nga Komisioneri, rezulton se LA është anëtar i subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”, e vërtetuar nëpërmjet formularit të anëtarësisë datë 20.08.2016.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe disfavorizues me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në faktet dhe provat e administruara, gjatë procesit të hetimit administrativ të ankesës nr. 106, datë 17.07.2018, të LA, Komisioneri vlerëson se dhënia e masave disiplinore nga ana e ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë ka qenë tendencioze për shkak të bindjeve politike të LA, për të arritur në largimin e ankuesit nga puna, pavarësisht se në vijim të zbatimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe shkronjën “ç”, pika 3, Kreu III, të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë” janë vënë në dijeni nga Departamenti i Administratës Publike për shkeljet e konstatuara nga punonjësi LA në lidhje me zbatimin e ligjit të sipërcituar.

Komisioneri vlerëson se nga ana e punëdhënësit, ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë nuk u sollën argumenta ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se dhënia e disa masave disiplinore të njëpasnjëshme ndaj tij, nuk ka ardhur si pasojë e bindjes së tij politike.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë. Pra, në këtë rast ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë, duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme.

⁵ Neni 7, pika 1, i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi parashikon: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

⁶ Në interpretim të nenit 1, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 82, pikat 2 dhe 3 e Kodit të Procedurës Administrative, lidhur me barrën e provës, parashikon se: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t’i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme”.

Referuar këtij parashikimi ligjor, ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër duhet të sillnin prova dhe parashtrime që të provonin të kundërtën e pretendimeve të ankuesit. Mirëpo, gjatë komunikimit shkresor me zyrën e Komisionerit, ISHMPUT ka arritur të argumentojë lirimin nga puna të punonjësit LA për shkak të moszbatimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe shkronjën “ç”, pika 3, Kreu III, të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë” por nuk ka arritur të argumentojë qëllimin e ligjshëm të dhënies së masave disiplinore të njëpasnjëshëm ndaj punonjësit LA.

Nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri gjykon se, paligjshmëria e veprimeve apo mos veprimeve nga ana e ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër në dëm të ankuesit, ka sjellë për pasojë edhe vendosjen e tij në kushte të disfavorshme, nga ana profesionale dhe morale.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në bazë të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, diskriminimi përkufizohet si: “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se LA, është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankuesit.

Neni 34, pika 1, e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se: “Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1, të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente, për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimi përpara organeve kompetente për ndjekje penale”. Në nenin 37, pika 1 e këtij ligji, parashikohet se: “Vendimi i

Gjykatës cakton dëmshpërblim nëse gjykata vendos që ka shkelje të këtij ligji, duke përfshirë edhe një afat kohor për kryerjen e zhdëmtimit”.

Komisioneri i rekomandon subjektin ankues që bazuar në sa më sipër citohet, mund t’i drejtohet gjykatës për dëmshpërblim.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 1, 2, 3/1, 7/1, 12, 13 nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasit L.A, nga ana e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale Gjirokastrë, për shkak të bindjes politike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(shkaku: bindja politike)
(fusha: punesim)